

Aneks 3: RAPORT I KONSULTIMIT PUBLIK

Draft Akti/Dokumenti i Politikës:

Dokumentit Strategjik “Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”

Kohëzgjatja e Konsultimit:

30 ditë

Aktivitetet e Konsultimit:

Për këtë qëllim, më 5 Korrik 2019 në ambjentet e MIE u mbajt një konsultim shumëpalësh, përfshirë këtu një tavolinë e rrumbullakët me aktorët e ndryshëm si dhe një pyetësor dërguar këtyre të fundit. Qëllimi ishte diskutimi për pikëpamjet dhe perspektivën nga të gjithë pjesëmarrësit në lidhje me vizionin aktual dhe të ardhshëm të Planit Kombëtar për Broadband, objektivave të përgjithshme të tij, si dhe qëllimet specifike. Gjithashtu, aktorëve ju kërkua të ndanin sfidat kryesore dhe prioritetet në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës broadband për periudhën 2020-2025.

Në Nëntor 2019 është prezantuar takimi i Grupit Tematik të Telekomunikacionit dhe Broadband të drejtuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me pjesëmarrje të përfaqësuesve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, operatorëve të telekomunikacionit etj. Cështjet e zhvillimit të infrastrukturës broadband dhe rolit të bashkive në këtë proces, u prezantuan dhe diskutuan gjatë seminarit të zhvilluar më 21 janar 2020, në kuadër të projektit për studimin e fizibilitetit për zhvillimin e broadbandit rajonal.

Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është zhvilluar procesi i konsultimit publik nëpërmjet publikimit të projektvendimit më datë 16.04.2020, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel ekspertit dhe qytetari), si dhe nëpërmjet publikimit në website-in e MIE

Afati për dërgimin e komenteve në regjistrin elektronik ka qenë 30 ditë pune.

Ka pasur:

Lexime si qytetar : 420

Lexime si ekspert : 324

Ndërkohë Planit Kombëtar i Broadband kishte 1 koment publik në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike në nivel qytetari, si dhe 15 komente nga tryezat e konsultimit dhe aktoret e tjerë

Aktorët e përfshirë:

Për procedim të mëtejshëm projektligji u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, AKEP, pushtetit vendor dhe autoriteteve, institucioneve të tjera që lidhen me përmbushjen e aktiviteteve dhe masave të këtij plani.

Komentet dhe Propozimet e marra:

Organizo komentet dhe propozimet e marra sipas çështjeve më të cilën lidhen. Mblidh komentet e përbashkëta dhe listo aktorët që i ngrenë ato. Shpjego nëse janë pranuar apo jo, dhe jep shkurtimisht arsyen.

Çështjet e konsultuara	Komentet e grumbulluara	Aktorët	Vendimi mbi komentet (pranuar/pranuar pjesërisht/refuzuar)	Justifikimi
Dokumenti Strategjik “Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”	15	organet rregullatore (AKEP, AMA), Insitucionet Publike: AKSHI, AKCESK, Ministrinë e linjës: Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme,	Disa komente u reflektuan. Komentet e përflektuara u dakordesuan	Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë përmes tryezave të konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përmes e-maileve, komente për secilin projektakt të konsultuar

		Bashkitë, Eksperte ITU persona juridikë privatë		
Dokumentit Strategjik “Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshmë të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”	https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/265	Qytetar (RENJK)	Komenti u pranua pjesërisht, si dhe janë dhënë shpjegime për të tjerat.	